



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2021:034802
Datë: 31.01.2025
Numri i dokumentit: 06789032

Pml.nr.33/2025

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Valdete Daka, kryetare, Agim Maliqi dhe Afrim Shala, anëtarë, me bashkëpunëtoren profesionale Qefsere Berisha, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të dënuarit G. Sh., për shkak të veprës penale vjedhja e rëndë nga neni 315 par.1 nënpar.1.2 të KPRK-së, duke vendosur përkitazi me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitur nga mbrojtësi i të dënuarit, kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm P.nr.319/2021 të datës 21.11.2023 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PA1.nr.257/2024 të datës 27.05.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më 30 janar 2025, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e mbrojtësit të të dënuarit G. Sh. e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PA1.nr. 257/2024 të datës 27.05.2024.

A r s y e t i m

Vendimi i Gjykatës Themelore

Gjykata Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin P.nr.319/2021 të datës 21.11.2023, të dënuarin G. Sh. e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale vjedhja e rëndë nga neni 315 par.1 nënpar.1.2 të KPRK-së, dhe e ka gjykuar me dënim burgimi me kusht në kohëzgjatje prej 3 (tri) vite i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në periudhën kohore prej 4 (katër) vite nuk kryen vepër tjetër penale. Të dënuarit A. T. dhe Z. M. i ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale ndihmë në vjedhje të rëndë nga neni 315 par.1 nënpar.1.2 lidhur me nenin 33 të KPRK-së, dhe i ka gjykuar secilin me dënim burgimi me kusht në kohëzgjatje prej nga 2 (dy) vite i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në periudhën kohore prej 2 (dy) vite nuk kryen vepër tjetër penale, kurse të dënuarin T. B. e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale blerja, pranimit ose fshehja e sendeve të përfituara me vepër penale nga neni 333 par.2 të KPRK-së, dhe e ka gjykuar me dënim burgimi me kusht në kohëzgjatje prej 4 (katër) muaj i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në periudhën kohore prej 1 (një) viti nuk kryen vepër tjetër penale. Të dënuarit janë obliguar në pagesën e shumës prej nga 20 €, në emër të paushallit gjyqësor dhe shumën prej nga 20 në emër të kompensimit të viktimave të krimit, kurse e dëmtuara për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest civil.

Vendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës

Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktgjykimin PA1.nr. 257/2024 të datës 27.05.2024, ka aprovuar si të bazuar ankesën e Prokurorisë Themelore në Prizren vetëm sa i përket vendimit për dënim dhe duke ndryshuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë dhe të dënuarit G. Sh. për veprën penale të shpallur fajtor i ka shqiptuar dënim burgimi në kohëzgjatje prej 1 (një) viti. Pjesët tjera të aktgjyimit kanë mbetur të paprekura.

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë

Kundër aktgjykimin të gjykatës së shkallës së dytë kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarit, avokati Bekim Parallangaj nga P., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës, ta aprovoj si të bazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, të anuloj aktgjykimin e kundërshtuar të gjykatës së shkallës së dytë dhe të e lë në fuqi aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Mendimi i Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit e Kosovës, me shkresën KMLP.II.nr.15/2025 e datës 23.01.2025 ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë të refuzohet si e pabazuar.

Pretendimet e paraqitura në kërkesë

Në kërkesë mbrojtësi i të dënuarit thekson se me aktgjykimin e kundërshtuar të gjykatës së shkallës së dytë nuk është bërë çmuarja e drejtë e pranimin të fajësisë nga ana e të dënuarit pasi që i njëjti në fazën fillestare edhe para ngritjes së aktakuzës ka bërë pranimin e fajësisë, kurse gjatë seancës fillestare ka deklaruar se i vjen keq për rastin e ndodhur dhe ndjehet i penduar duke kërkuar falje të dëmtuarës dhe familjarëve të saj, si dhe duke bërë kompensimin e saj. Për më tepër, nuk është vlerësuar fakti se në kohën e kryerjes së veprës penale i dënuari nuk ka qenë i vetëdijshëm për veprimet e tij e vërtetuar edhe përmes raportit specialistik të ordinancës psikiatrike "...", me ç'rast është përshkruar se i dënuari ka sjellje të pa kontrolluara. Andaj konsiderohet se të gjitha këto rrethana nuk janë marrë parasysh nga ana e gjykatës së shkallës së dytë me rastin e ndryshimit të vendimit për dënim, përkatësisht shqiptimin e dënimit efektiv i cili dënim nuk është në përputhje me rrethanat lehtësuese.

Gjetjet e Gjykatës Supreme të Kosovës

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të KPPK-së dhe pas vlerësimit të pretendimeve në kërkesë, gjeti se:

- kërkesa nuk është e bazuar.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, pretendimet e mbrojtësit të të dënuarit janë të pabazuara, ngase aktgjykimi i kundërshtuar kundër të cilit është parashtruar kërkesa, nuk përmban shkelje për të cilat pretendohet.

Duke vlerësuar pretendimet e mbrojtësit të të dënuarit fillimisht duhet theksuar faktin se i dënuari në shqyrtimin fillestar kishte bërë pranimin e fajësisë (mirëpo i cili pranim ishte refuzuar

për shkak se të pandehurit e tjerë nuk e kishin pranuar fajësinë) dhe gjithashtu edhe gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor kishte pranuar fajësinë dhe si rezultat i konstatimit të gjykatës se janë përmbushur kriteret e përcaktuara, pranimi i fajësisë është aprovuar.

Gjykata Supreme e Kosovës duke vlerësuar pretendimet e theksuara përkitazi me shkeljen e ligjit penal, përkatësisht se ndaj të dënuarit është shqiptuar dënim i ashpër dhe me këtë rast është bërë shkelja e ligjit penal, *vlerësoj se në mënyrë të drejtë është zbatuar ligji penal nga ana e gjykatës së shkallës së dytë, meqë ndryshimi i aktgjykimit ishte bërë sipas ankesës së Prokurorisë Themelore në Prizren dhe me këtë rast të dënuarit i është shqiptuar dënimi i përcaktuar nën minimumin e dënimit të përcaktuar për veprën penale të shpallur fajtor, pasi që për veprën penale të shpallur fajtor është paraparë dënimi me burgim prej 3 (tre) deri në 7 (shtatë) vjet, kurse dënimi i shqiptuar është me 1 (një) vit burgim.*

Megjithatë, *bazuar në dispozitën e nenit 385 par.5 të KPPK-së kur është fjala për vendimin për dënim, dënim alternativ, vërejtje gjyqësore ose në marrjen e vendimit për masën e trajtimit të detyrueshëm për rehabilitim apo për konfiskim të dobisë pasurore të fituar me veprën penale, shkelja e ligjit penal bëhet në rastet kur në marrjen e vendimit për dënim gjykata i ka tejkualuar kompetencat ligjore. Pra, nuk është në kompetencë të Gjykatës Supreme të Kosovës shqyrtimi i lartësisë së dënimit të shqiptuar, por e rëndësishme është se me rastin e shqiptimit të dënimit nuk janë tejkualuar kompetencat ligjore dhe arsyet e dhëna për vendimin për dënim, nuk janë të përfshira në shkelje procedurale. Përtej kësaj, gjykata e shkallës së dytë në faqen e pestë dhe të gjashtë të aktgjykimit të saj ka dhënë arsyetim të hollësishëm për të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese dhe mbi këtë bazë me rastin e shqiptimit të dënimit ka theksuar se dënimi i shqiptuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë është tepër i ulët në raport me mënyrën e kryerjes së veprës penale dhe faktin se bazuar në të dhënat nga evidenca penale rezulton se i dënuari është recidivist i veprave të ngjashme penale (të përshkruara në aktgjykimet e gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë), andaj nga kjo del se arsyetimin e dhënë nga gjykata e shkallës së dytë e aprovon në tërësi edhe Gjykata Supreme e Kosovës. Përtej kësaj duke analizuar raportin mjekësor të të dënuarit fillimisht del se i njëjti nuk ishte prezantuar si provë në këtë çështje penale, megjithëse ky raport nuk vë në pikëpyetje gjendjen mendore të të dënuarit, por përshkruan aspektin e sjelljes dhe disponimit të tij.*

Nga sa u parashtrua më lartë e në kuptim të nenit 437 par.1 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pml.nr.33/2025, më 30 janar 2025

B.profesionale,
Qefsere Berisha

Kryetarja e kolegjit,
Valdete Daka